



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1480 Prot.

Lezhë, më 04 . 02 . 2022

VENDIM

Nr. 6 Datë 01 . 02 . 2022

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE
PËR KËMBËSORET DHE BIÇIKLETAT NË FSHATIN ISHULL LEZHË”

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Thirrjes për Aplikime për Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin të shpallur nga Programi Për Zhvillimin Rajonal Shqipëri (PZHRSH), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), si dhe shkresës së Programit për Zhvillim Rajonal Shqipëri protokolluar në Bashkinë Lezhë më Nr.21379 Prot., Datë 22.12.2021, ku informojnë se Bashkia Lezhë është shpallur fituese e projektit “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për këmbësorët dhe biçikletat në fshatin Ishull Lezhë” dhe kërkojnë plotësimin e disa dokumentave si kusht për firmosjen e kontratës së grantit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për këmbësorët dhe biçikletat në fshatin Ishull Lezhë”.
2. Ngarkohet për të lidhur kontratën dhe për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

